

NË MBËSHTETJE TË TË MBIJETUARVE TË DHUNËS NË FAMILJE NË SHQIPËRI GJATË PANDEMISË COVID-19!

Qendra për Nisma Ligjore Qytetare (QNL) po ofron mbështetje për të mbijetuarit e dhunës në familje në Shqipëri, mundësuar nga granti i përgjigjes urgjente për ofruesit e shërbimeve kundër dhunës në familje gjatë krizës COVID-19, falë mbështetjes së Fondacionit Oak.

Brenda kuadrit të këtij projekti, të mbijetuarit e dhunës në familje përfituan nga ndihma juridike falas dhe mbështetja në formën e paketave ushqimore, paketave higjienike, ilaçeve, si dhe transportit falas dhe të sigurt drejt strehëzave për gratë dhe vajzat e dhunuara, apo institucioneve të tilla si gjykata, prokuroria, etj.

Kush u mbështet gjatë periudhës shtator-nëntor 2020?

Gjatë periudhës shtator-nëntor 2020, QNL mbështeti 49 gra dhe vajza të dhunuara me ndihmë juridike falas dhe facilitete të tjera. Gjatë dhjetorit, numri i përfituesve, viktimat të dhunës në familje, është më shumë se 60.

Për të mësuar më shumë, lexoni revistën Fempower në link-un më poshtë

<https://www.wave-network.org/2020/12/30/fempower-magazine-2020/>